REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 509/1 Prot. Tiranë, më 24.05.2023

**VENDIM**

**Nr. 27, datë 24/05/2023**

**MBI**

**"MIRATIMIN PARAPRAK TË HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT PËR FORMIMIN E VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJIKE , NË ARTE SI DHE TË PLANIT MËSIMOR, TË PARAQITUR NGA DEPARTAMENTI AKTRIM DHE TEORI, PRANË FAKULTETIT TË ARTIT SKENIK"**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në pikën 1 dhe 2 të nenit 3, në pikën 1, shkronja dh të nenit 38, në pikën 1 të nenit 71 si dhe në nenin 81 të ligjit nr. 80/2015, për "*Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "*Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë*", i ndryshuar, Udhëzimin Nr. 3, datë 15.02.2023 "*Për përcatimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies nëa rsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike*", pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga FAS, si dhe pas diskutimeve, me votim të hapur, unanimisht,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin paraprak të dokumentacionit për hapjen e programit të studimit **"Për formimin e vazhduar në fushën psiko-pedagogjike", në Arte** si dhe **të planit mësimor**, të paraqitur nga Departamenti Aktrim dhe Teori pranë Fakultetit të Artit Skenik, sipas materialit bashkëlidhur.

2. Ky vendim t'i dërgohet për miratim Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve dhe më pas të përcillet në MASR për miratim përfundimtar, në përputhje me pikën 4, Kreu II i Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2023.

3. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

| | |
|---|---|
| Prof. Kastriot ÇAUSHI | Prof. Najada HAMZAJ |
| Prof. Dr. Isak SHEHU | Prof. Petrit MALAJ |
| Prof. Artan PEQINI | Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA) |
| Prof. Arben LLOZI | Prof. Ilir MARTINI |
| Prof. Asoc. Dorian ÇENE | Prof. Gazmend GJOKA |
| Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA | Prof. Dr. Erald BAKALLI |
| Prof. Endri SINA | Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI |
| Prof. Asoc. Albes FUSHA | Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI |
| Prof. Asoc. Genci FUGA | Erlind FUSHA (Student FAB) |
| Sindi ZDRAVA (Studente FM) | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË

Nr 521 Prot
27/05/2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**FAKULTETI I ARTIT SKENIK**
**DEKANI**

Nr. 133 prot. Tiranë, më 12/05/2023

**Lënda:** Kërkesë për miratimin në Senatin e UART dhe Bordin e Administrimit të dosjes me dokumentacionin e duhur për hapjen e programit të studimit të vazhduar në fushën psiko pedagogjike.

**REKTORIT TE UNIVERSITETIT TE ARTEVE**

**Prof. KASTRIOT ÇAUSHI**

Z.Rektor,

Bazuar në udhëzimin e MAS nr.3 datë 15/02/2023 për "*Përcaktimin e Diplomave Universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta në Fushën/Lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në fushën psiko-pedagogjike,* Departamenti Aktrim & Teori pranë Fakuletetit të Artit Skenik, organizoi dhe përpunoi dosjen e duhur për miratimin e planit mësimor me 35 kredite të "*Çertifikatës së Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko pedagogjike",* konform projektit të hartuar nga Grupi i Punës i ngritur nga MAS.

Bashkëngjitur kësaj shkrese po ju dërgojmë dosjen përkatëse me dokumentacionin e duhur e cila shërben për të miratuar "Rregulloren e Programit të Studimit dhe Çertifikatës së Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko pedagogjike"

Për arsye të kohës së limituar për aplikimin në MAS, do të kërkonim nga ju miratimin sa më parë të vendimeve përkatëse në Senatit Akademik dhe Bordin e Administrimit të UART.

Ju faleminderit!

**Prof. Petrit MALAJ**

**DEKAN**

**FAKULTETI I ARTIT SKENIK**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**FAKULTETI I ARTIT SKENIK**
**DEPARTAMENTI AKTRIM DHE TEORI**

Tiranë 12/05/2023

## VENDIM Nr 05

## Datë 12/05/2023

Departamenti Aktrim & Teori pranë Fakultetit të Artit Skenik në Universitetin e Arteve, pasi analizoi në mbledhjen e rradhës produktin e paraqitur me dokumentacionin përkatës në përgjigje të kërkesave që ka *Udhëzimi Nr 3 datë 15.2.2023* i MAS-ës për " Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlershme, të Ngjashme ose të Përafërta në Fushën/Lëndët e mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen e Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psikopedagogjike :

## Vendosi;

1. Të miratojë planin mësimor me 35 kredite të Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psikopedagogjike', konform projektit të hartuar nga Grupi i Punës i ngritur nga MAS.
2. Të miratojë Rregulloren e Programit të Studimit të " Programit të Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psikopedagogjike"

**Përgjegjësi i Njësisë Bazë Aktrim & Teori**

**Prof. Gazmend GJOKA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI ARTEVE
FAKULTETI ARTIT SKENIK

**Plani Mësimor i Programit të Studimit**

**" Çertefikatë e Formimit të Vazhduar në Fushën Psikopedagogjike "**

**Viti Shkollor 2023-2024**

**Miratoi**

**REKTORI**

**Prof . Kastriot Çaushi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Plani Mësimor**

**Programit studimit " Çertefikatë e Formimit të Vazhduar në Fushën Psikopedagogjike "**

**Viti Akademik 2023-2024**

| Nr | Emertimi Lendes | Kredite | Ore Gjithsej | Ore leksione | Ore seminare | Ore praktike | Orë jashte Auditorit | Ngarkesa javore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Zhvillimi Kurrikulcs | 5 | 125 | 30 | 30 | | 65 | 2/2 |
| 2 | Metodologji e mësimdhënies | 7 | 175 | 60 | 30 | | 85 | 4/2 |
| 3 | Vlerësimi në Arsim | 6 | 150 | 30 | 30 | | 90 | 2/2 |
| 4 | Psikologji Zhvillimi | 6 | 150 | 60 | 15 | | 75 | 4/1 |
| 5 | Teori te nxeni & Menaxhimi Klasës | 3 | 75 | 15 | 15 | | 45 | 1/1 |
| 6 | Praktika mesimore | 3 | 75 | | | 75 | | 0/2 |
| 7 | Prova Finale | 5 | 125 | | | | 125 | |
| | **TOTALI** | **35** | **875** | **195** | **120** | **75** | **485** | |

**Përgjegjësi Departamentit**
**Prof. Gazmend Gjoka**

**DEKANI**
**Prof. Petrit MALAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK

Nr. 133/1 Prot Tiranë, më 12 / 05 /2023

**Lënda:** Lista e plote emërore e personelit akademik me kohe të plotë dhe të pjesshme për ofrimin e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushen psiko-pedagogjike në FAS.

Personeli akademik i planifikuar për tu angazhuar në programin e studimit të formimit të vazhduar për rastin e hapjes së programit të ri të studimit ne fushën psiko-pedagogjike në arte për vitin e ri akademik 2023-2024 , i cili do të ofrohet pranë Departamentit " Aktrim dhe Teori ", pranë Fakultetit të Artit Skenik do të jetë si më poshtë:

| Personeli Akademik i angazhuar në programin e studimit | Titulli/ Grada | Departamenti | Kohë e plotë/ kohë e pjesshme | Kohëzgjatja e kontratës | Ngarkesa Mësimore |
|---|---|---|---|---|---|
| Elida RAPTI | Prof.Asoc | Aktrim dhe Teori | Me kohë të plotë | Me kohëzgjatje të pa caktuar | 150 |
| Ndriçim MEHMETI | Prof.Asoc | Aktrim dhe Teori | Me kohë të pjesshme | Me kohë të pjesshme | 75 |
| Manjola TERSHANA | Dr. | Aktrim dhe Teori | Me kohë të plotë | Me kohëzgjatje të pa caktuar | 275 |
| Majlinda HALA | Dr | Aktrim dhe Teori | Me kohë të plotë | Me kohëzgjatje të pa caktuar | 250 |

**Përgjegjësi Departamentit**
**Prof. Gazmend Gjoka**

**DEKANI**
**Prof. Petrit MALAJ**

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2, 1019, Tiranë, Shqipëri, Tel: +355 42 225 488, www.uart.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK

# LETËR ANGAZHIMI

Unë Prof.Ass Ndriçim Mufit Mehmeti, personel akademik në programin e studimit Aktrim-Mësuesi departamenti Aktrim-Teori, pranë Fakultatit të Artit Skenik në UART me anë të kësaj letre, paraqes angazhimin tim si lektor në Programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike për vitin akademik 2023-2024. Angazhimi im do të realizohet bazuar në *"Rregulloren e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit "*, përkatësisht në FAS, të miratuar me vendim të senatit akademik.

Ndriçim Mehmeti

Emër/mbiemë/firmë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

# DIPLOMË

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 60; në VKM-në nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar; kreu II dhe IV, si dhe në Vendimin nr. 398 datë 07.12.2022 të Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të Universitetit të Tiranës,

Z/Zj. Ndriçim Mufit Mehmeti lindur më 14 . 11 . 1969
(emër atësi mbiemër)

**Fiton titullin:**

## *Profesor i Asociuar*

Nr. Regjistri AKKSHI B252

Tiranë më 06.02.2023
Nr. i Diplomës 124

Kryetari i KPPA-së
Prof. Dr. Skënder KAÇUPI

Rektori
Prof. Dr. Artan HOXHA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**FAKULTETI I ARTIT SKENIK**

# LETËR ANGAZHIMI

Unë Prof.Ass Nikolai Lopti, personel akademik në programin e studimit Aktrimi dhe mësuesi departamenti Aktrimi i Teatrit, pranë Fakultatit të Artit Skenik në UART me anë të kësaj letre, paraqes angazhimin tim si lektor në Programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike për vitin akademik 2023-2024. Angazhimi im do të realizohet bazuar në *"Rregulloren e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit "*, përkatësish në FAS, të miratuar me vendim të senatit akademik.

Nikolai Lopti [signature]

Emër/mbiemë/firmë

UNIVERSITETI I ARTEVE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE

mash
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

# *Diplomë*

*Bazuar ne Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" në VKM nr. 467, datë 18. 07. 2007 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor e pedagogjik të personelit akademik" (i ndryshuar) si dhe Vendimin nr. 14..... datë 25.06.2014 të Këshillit të Profesorëve të Fakultetit të Artit Skenik..... të Universitetit të Arteve.*

*Znj/Z. Elida Agim Rapti lindur më 03.06.1962*
*fiton titullin*

## *Profesor i Asociuar*

*Nr. i Regjistrit të KVTA 991..... Nr. i dëshmisë 32 Tiranë më 15.07.2014*

Dekani
Prof. Kastriot Çaushi

Rektori
Prof. Petrit Malaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**FAKULTETI I ARTIT SKENIK**

## LETËR ANGAZHIMI

Unë Dr. Majlinda Skënder Hala, personel akademik në programin e studimit Aktrim dhe Mësuesi departamenti Aktrim dhe Teatër pranë Fakultatit të Artit Skenik në UART me anë të kësaj letre, paraqes angazhimin tim si lektor në Programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike për vitin akademik 2023-2024. Angazhimi im do të realizohet bazuar në *"Rregulloren e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit"*, përkatësish në FAS, të miratuar me vendim të senatit akademik.

Majlinda Hala
Emër/mbiemë/firmë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

# DOKTORATË

në

## Shkencat Etnologjike dhe Folklor

(Program i hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 1164, datë 25.11.2009)

Mbështetur në ligjin Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucioner e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
Në diplomën "Master i Shkencave" Nr. 42 ;
Si dhe në Vendimin e Jurisë te ngritur pranë Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, nr. 520, datë 10.07.2015, për mbrojtjen e doktoratës, që e vlerëson me **92.6 pikë (shumë mirë)** disertacionin me temë:

**"Krijimtaria folklorike për fëmijë. Këngët lodra dhe ritualet",**

*Znj. Majlinda Skënder Hala*

...rikullimit QS225N000033

...stnr të KVTA 1594

Dt. e regjistrimit 28.02.20...

Nr. i diplomës ...

Dt. e lëshimit të diplomës 18.12.20...

lindur në Tiranë , më 23.12.1970

fiton gradën shkencore

# DOKTOR

QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Dekani

... Dr. Mi...r DIBRA

Rektori

Prof. Dr. A... MARAS...

REPUBLIKA E SHQIPËRISË QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**
**FAKULTETI I ARTIT SKENIK**

# LETËR ANGAZHIMI

Unë Dr. Margjela Moisi Tërshana, personel akademik në programin e studimit Aktrim dhe Mësim departamenti Aktrim dhe Teori, pranë Fakultatit të Artit Skenik në UART me anë të kësaj letre, paraqes angazhimin tim si lektor në Programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike për vitin akademik 2023-2024. Angazhimi im do të realizohet bazuar në *"Rregulloren e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit "*, përkatësish në FAS, të miratuar me vendim të senatit akademik.

Margjela Tërshana
Emër/mbiemë/firmë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**

# *DOKTORATË*

*në*

## *Shkencat Gjuhësore*

**(Program i hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 1164, datë 25.11.2009)**

Mbështetur në ligjin Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
Në diplomën "Master i Shkencave", Nr. 15 ;
Si dhe në Vendimin e Jurisë të ngritur pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, nr. 303, datë 20.07.2016, për mbrojtjen e doktoratës, që e vlerëson me **88.6 pikë (shumë mirë)** disertacionin me temë:

**"Kontributi i De Radës në kërkimet gjuhësore mbi shqipen",**

*Znj. Manjola Moisi Tërshana*

lindur në Tiranë , me 08.04.1968

fiton gradën shkencore

# *DOKTOR*

Nr. i matrikullimit QS223N010012

Nr. i regjistrit të KVTA 2397

Dt. e regjistrimit 17.07.2013

Nr. i diplomës 15

Dt. e lëshimit të diplomës 17.10.2016

Dekani

Prof. Dr. Valter MEMISHA

Rektori

Akademik. Prof. Dr. Marenglen VERLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
TIRANË

Scanned by TapScanner

REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri, Tel: +355 42 247 598, www.uart.edu.al

**DEPARTAMENTI AKTRIM & TEORI**

**PROGRAMI I STUDIMIT "FORMIMIT VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJIKE PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË RREGULLUAR TË MËSUESIT"**

# PROGRAMII LËNDËS

# ZHVILLIMI I KURRIKULËS

**Viti akademik 2023-2024**

**Titullari i Lëndës**
**Dr. Manjola Tërshana**

**Përgjegjësi i Njësisë Bazë**
**Prof.Gazmend GJOKA**

**Dekani**
**Prof. Petrit MALAJ**



Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri, Tel: +355 42 247 598, www.uart.edu.al

# PARAQITJAE LËNDËSNGAPEDAGOGU

| | |
|---|---|
| **NUMRI I KREDITEVE** | **4 ECTS** |
| **NUMRI I ORËVE MËSIMORE NË KLASË** | **45 ORË** |
| **FORMA E MËSIMDHËNIES** | **LEKSIONE** |
| **VITI AKADEMIK** | **2023-2024** |
| **SEMESTRI KUR ZHVILLOHET** | **I PARË** |
| **LLOJI I LËNDËS** | **E DETYRUESHME** |
| **PROGRAMI I STUDIMIT** | **Formimi Vazhduar në Fushen Psiko-Pedagogjike për Profesionin e Rregulluar të Mesuesit"** |
| **ADRESA ELEKTRONIKE E TITULLARIT/E PEDAGOGUT TË LËNDËS** | |
| **KODI I ETIKËS** | **Në tërësi VSA Nr. 23. Datë 06.03.2020, Mbi miratim e Kodit të Etikës në UART** |

## PËRMBLEDHJA E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT

**Objektivat e lëndës:**
Ky program synon t'i njohë studentët me kontekstin shqiptar të zhvillimit të kurrikulës, me kornizën kurrikulare, planet mësimore, programet mësimore, tekstet shkollore, vlerësimin e kurrikulës, zhvillimin profesional të mësuesit, mbrojtjen e fëmijëve, si dhe planifikimin e orës së mësimit.

Programi i studimit të lëndës synon t'u vijë në ndihmë studentëve për t'u njohur me qëllimet, objektivat dhe përmbajtjen e kursit. Gjithashtu, studentët njihen me grafikun e mësimeve të ndara për çdo javë, detyrimet që studenti ka për të shlyer gjatë gjithë periudhës së studimit, mënyrën e vlerësimit dhe literaturën e nevojshme.

**Qëllimi i lëndës:**
Qëllimi i kursit "Zhvillimi i kurrikulës" është:

- T'u japë mundësi studentëve të thellojnë kuptimin e tyre mbi kurrikulën shkollore shqiptare, duke u fokusuar në punën studimore.
- Studentët do të kenë mundësi të njihen me çështjet kryesore teorike mbi kurrikulën dhe do të zhvillojnë strategji për të vlerësuar kurrikulën shkollore, sidomos çështjet që duhet të përballin nxënësit dhe mësuesit kur duhet të punojnë me të.

Një nga elementet e rëndësishëm të formimit të mësuesve është njohja më kurrukulat dhe procesin e

zhvillimit të tyre.

Programi i studimit të lëndës synon t'u japë studentëve një vështrim të përgjithshëm të bazave, parimeve dhe problemeve të kurrikulës: *bazat e kurrikulës:* filozofike, historike, psikologjike, sociale dhe teorike, që ndikojnë në këtë të fundit; *parimet:* që kanë të bëjnë me mjetet dhe metodat e përdorura për kurrikulën, për zhvillimin, hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e kurrikulës, qëllimet, synimet dhe objektivat e kurrikulës; *problemet:* merren me teoritë dhe problemet e sotme, si dhe prirjet dhe drejtimet në të ardhmen

## KONCEPTET THEMELORE DHE TERMAT BAZË MBI TË CILAT NDËRTOHET LËNDA

- Krijimi i vizionit të qartë mbi parimet e ndërtimit të kurrikulës
- Krijimi i bindjeve për nevojën e zhvillimit të kurrikulës.
- Debatimi rreth risive që ndodhin në zhvillimin e kurrikulës, kurrikulat moderne e postmoderne, si dhe për planifikimin e orës së mësimit.
- Dhënia e kontributit në përmirësimin e kurrikulës dhe planifikimin e mësimit.
- Aftësimi për vlerësimin e të gjithë elementeve të kurrikulës.
- Njohja dhe aftësimi i studentëve për promovimin, menaxhimin, mbrojtjen, zhvillimin dhe mbrojtjen e të drejtave fëmijëve

## TEMAT E LËNDËS

(Janë shpjegim rreth një paragraf i çdo teme të leksionit sipas javëve shoqëruar me literaturën përkatëse.)

| PERIUDHA | TEMA |
|---|---|
| SEMESTRI I PARË | |
| **JavaeI** | Fusha e kurrikulës, metodat e kurrikulës |
| **JavaeII** | Parimet e ndërtimit të kurrikulës |
| **JavaeIII** | Metodat teknike e shkencore dhe joteknike joshkencore te kurrikulës |
| **JavaeIV** | Hartimi i kurikulës. Modelet përfaqësuese te kurrikulës |
| **Javae V** | Qëllimi, synimi dhe objektivat . Nivelet klasifikuese të objektivave arsimorë |
| **Javae VI** | Planet mësimore, programet mësimore. Tekstet shkollore. Procesi i hartimit të tyre. |
| **Javae VII** | Kurrikula dhe shoqëria |
| **Javae VIII** | Përmirësimi i kurrikulës |

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel: +355 42 247 598, www.uart.edu.al

| | |
|---|---|
| **JavaeIX** | Zbatimi i kurrikulës |
| **Javae X** | Vlerësimi i kurrikulës |
| **Javae XI** | Mësuesit dhe zhvillimi profesional. Planifikimi vjetor i mësimit |
| **Javae XII** | Kurrikula plotësuese, probleme të reja për nxënësit"në rrezik". Identifikimi i fëmijëve në rrezik. Abuzimi. Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe abuzimi. Dhuna në familje. |
| **Javae XIII** | Kurrikula dhe mbrojtja e fëmijëve në shkolla. Konventa mbi të drejtat e fëmijës. Aktorët dhe përgjegjësitë në rrjetin e mbrojtjes së fëmijëve në shkolla, politika e mbrojtjes se fëmijëve në shkolla dhe standardet e shkollës për mbrojtjen e fëmijëve. |
| **Javae XIV** | Arsimi shumëkulturor, Arsimi për të gjithë nxënësit. Grupet e reja në vështirësi edukimi dhe mbrojtja e tyre.Komunikimi.Mjedisi miqësor me fëmijët. |
| **Javae XV** | Prindërit dhe komuniteti si partnerë në edukim dhe në mbrojtjen e fëmijëve. |
| **TEMA E SEMINAREVE** | |
| **JavaeI** | Hyrje, prezantim i detyrimeve, paraqitje e programit të lëndës |
| **JavaeII** | Diskutim: Si ndërtohet kurrikula |
| **JavaeIII** | Debat: mbështesni Metodat teknike apo ato joteknike te ndërtimit të kurrikulës |
| **JavaeIV** | Paraqitje e grupeve të punës mbi Hartimin e kurikulës. |
| **Javae V** | Detyrë në grup: Hartimi i Qëllimit, synimit dhe objektivave për një orë mësimore |
| **Javae VI** | Punë përfaqësuese: çfarë hapësire kanë mësuesit për të hartuar vetë planet mësimore, programet mësimore. |
| **Javae VII** | Debat: A influencohet Kurrikula nga shoqëria? |
| **Javae VIII** | Diskutim: si mund të përmirësohet kurrikula |
| **JavaeIX** | Punë në grup për zbatimin e një ore ekstrakurrikulare |
| **Javae X** | Diskutim: a duhet të përfshihen aktorë të tjerë në vlerësimin e kurrikulës |
| **Javae XI** | Paraqitje e detyrës në grup |
| **Javae XII** | Paraqitje e detyrës në grup |

| | |
|---|---|
| **Javae XIII** | Debat: a duhet të përfshihen nxënësit me aftësi të kufizuar në shkollat e zakonshme |
| **Javae XIV** | Diskutim: Ç'duhet të bëjë mësuesi kur evidenton një nxënës "në rrezik" |
| **Javae XV** | Debat: Jemi pro globalizimit apo nacionalizmit në Arsim? |

## FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

### FREKUENTIMI

1. Studenti duhet të frekuentojë jo më pak se 75% tëlëndës në auditor.
2. Nëse frekuentimi i studentit është më pak se 75% e lëndës në një vit akademik, atëherë ai detyrohet të kalojë në frekuentimin e saj në vitin pasardhës sipas rregullores së ciklit të parë të studimeve të UART.

### KONTROLLI I VAZHDUESHËMDO TË NXIRRET NGA KËTO ELEMENTE:

**a)** Pjesëmarrje aktive në orën e mësimit: **10%**
**b)** Puna e pavarur krijuese: **20%**
**c)** Detyrat e kursit: **20%**
**d)** Projektet e kursit: **20%**
**e)** Provimi përfundimtar: **30%**

### SISTEMI I VLERËSIMIT TË STUDENTIT

| Nota | Në % | Përkufizimi |
|---|---|---|
| 10 | 91-100% | SHKËLQYESHËM |
| 9 | 81-90% | SHUMË MIRË |
| 8 | 71-80% | MIRË |
| 7 | 61-70% | KËNAQSHËM |
| 6 | 51-60% | MJAFTUESHËM |
| 5 | 40-50% | DOBËT |
| 4 | 00-39% | KEQ |

### LITERATURA

**Literaturë bazë e detyrueshme**

Marsh, C. J. (2009) Koncepte themelore për ta kuptuar kurrikulumin, CDE, Tiranë, fq. 3-19; 23-35; 36-45; 92-109; 113-127; 205-219; 162-171; 247-283.

Noddings, N. (2007) Philosophy of Education, second edition, Westview Press, fq. 15-27; 97-124.

Orstein A., Hunkins, F (2005) "*Kurrikula, bazat, parimet dhe problemet,* Instituti i Studimeve pedagogjike. Fq. 22-56; 74-87; 91-103; 113-251, 345-357.

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel: +355 42 247 598, www.uart.edu.al

| |
|---|
| Slattery, P. (2012) *Curriculum design in the post-modern era* (version elektronik) fq. 67-89; 91, 112.<br><br>Grup autorësh (2010) *Udhëzues kurrikular – material ndihmës për mësuesit e gjimnazit, drejtimi shoqëror*,IZHA fq. 11-28, 32-45. |
| **Literatura ndihmëse** |
| **1.** Making the curriculum work. Botim i "Centre for educational research and innovation".<br>**2.** www.arsimi.gov.al; www.izha.edu.al |
| **Vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës, nëse ka.** |

**Pedagogu i Lëndës**

**Dr. Manjola Tërshana**



Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel: +355 42 247 598, www.uart.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel: +355 42 247 598, www.uart.edu.al

**DEPARTAMENTI AKTRIM & TEORI**

**PROGRAMI I STUDIMIT "FORMIMIT VAZHDUAR NE FUSHEN PSIKO-PEDAGOGJIKE PER USHTRIMIN E PROFESIONIT TE RREGULLUAR TE MESUESIT"**

**PROGRAMII LËNDËS**

**VLERËSIMI NË ARSIM**

**Viti akademik 2023-2024**

**Titullari i Lëndës**
**Dr. Manjola Tërshana**

**Përgjegjësi i Njësisë Bazë**

**Prof.Gazmend GJOKA**

**Dekani**

**Prof. Petrit MALAJ**

REPUBLIKA E SHQIPERISE FAKULTETI I ARTIT SKENIK UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANE

## PARAQITJAE LËNDËS NGA PEDAGOGU

| | |
|---|---|
| **NUMRI I KREDITEVE** | **4 ECTS** |
| **NUMRI I ORËVE MËSIMORE NË KLASË** | **45 ORË** |
| **FORMA E MËSIMDHËNIES** | **LEKSIONE** |
| **VITI AKADEMIK** | **2023-2024** |
| **SEMESTRI KUR ZHVILLOHET** | **I PARË** |
| **LLOJI I LËNDËS** | **E DETYRUESHME** |
| **PROGRAMI I STUDIMIT** | **Formimit Vazhduar në fushën Psiko – Pedagogjike për Profesionin e rregulluar të Mësuesit** |
| **ADRESA ELEKTRONIKE E TITULLARIT/E PEDAGOGUT TË LËNDËS** | manjolatershana@yahoo.com |
| **KODI I ETIKËS** | **Në tërësi VSA Nr. 23. Datë 06.03.2020, Mbi miratim e Kodit të Etikës në UART** |

## PËRMBLEDHJA E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT

**Objektivat e lëndës:**

Vlerësimi në arsim, bazuar në rezultatet e të nxënit, përfshin gjykimin për arritjet e nxënësve (njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime) përkundrejt niveleve të arritjes së kompetencave të të nxënit.Në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, siguron përdorimin e të gjitha llojeve të vlerësimit, të cilët përcaktohen si të domosdoshëm për të vlerësuar arritjet dhe zhvillimin individual, për të evidentuar anët dhe pikat e forta, si dhe drejtimet te të cilat çdo nxënës ka nevojë për ndihmë, mbështetje dhe motivim. Vlerësimi realizohet nëpërmjet përdorimit të instrumenteve dhe të procedurave të ndryshme të mbledhjes së të dhënave, interpretimit dhe analizës së tyre në dobi të përmirësimit të mësimdhënies dhe të të nxënit. Njohja më e mirë e nxënësit dhe e arritjeve të tij e ndihmon mësuesin dhe prindin të punojnë më tepër në ato drejtime, të cilat pengojnë ecurinë dhe përparimin e tij të mëtejshëm. Kohë pas kohe, gjykimi për atë çfarë arrin nxënësi sinjalizon të rriturin si po lëviz trajektorja e progresit të tij.

**Qëllimi i lëndës:**

Lënda ka si qëllim t'u zhvillojë studentëve kompetencat për vlerësimin në arsim. Lënda është e destinuar për studimet në Programin Master Mësuesi. Ajo përbëhët nga dy pjesë: baza të vlerësimit dhe aspekte të vlerësimit në arsim. Lënda është ndërtuar mbi 10 tema qëndrore dhe një shumëllojshmëri çështjesh. Ky është një kurs i thelluar për vlerësimin në arsim dhe është përqendruar në 5 objekte vlerësimi: vlerësimi i sistemit arsimor, vlerësimi i shkollës, vlerësimi i programeve, vlerësimi i nxënësve dhe vlerësimi i mësuesve

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel: +355 42 247 598, www.uart.edu.al

## KONCEPTET THEMELORE DHE TERMAT BAZË MBI TË CILAT NDËRTOHET LËNDA

- konceptet kryesore që lidhen me vlerësimin në arsim;
- çështjet e vlerësimit në arsim;
- aftësinë për të përzgjedhur modele, metoda dhe instrumente për vlerësimin e sistemit, shkollës, programeve, nxënësve, mësuesve;
- aftësinë për të përdorur modele, metoda, instrumente të vlerësimit për çështje të arsimit;
- analiza, plane dhe politika për vlerësimin e një aspekti që lidhet me sistemin, shkollën, programin, nxënësit, mësuesit;
- qëndrimin e duhur profesional për çështje konkrete të vlerësimit në arsim;
- shkruajë raporte vlerësimi;
- prezantojë para një audience rezultatet e një vlerësimi.

| PERIUDHA | TEMAT E LEKSIONEVE | |
|---|---|---|
| | **SEMESTRI I PARE** | |
| **JavaeI** | **Kuptimi i vlerësimit**<br><br>- Kuptimi i matjes<br>- Kuptimi i vlerësimit<br>- Objektet e vlerësimit<br>- Funksionet e vlerësimit<br>- Procesi i vlerësimit<br>- Tipat e vlerësuesve<br>- Standardet e vlerësimit | 2 |
| **JavaeII** | **Tipa të vlerësimit**<br>- Vlerësimi formues<br>- Vlerësimi përmbledhës<br>- Vlerësimi i kontekstit<br>- Vlerësimi i burimeve<br>- Vlerësimi i nevojave<br>- Vlerësimi i procesit<br>- Vlerësimi i produkteve<br>- Vlerësimi i rezultateve<br>- Vlerësimi i ndikimit | |
| **JavaeIII** | **Tipa të vlerësimit arsimor**<br>- Programe të vlerësimit kombëtar<br>- Programe të vlerësimit ndërkombëtar<br>- Raportimi i performancës së shkollës<br>- Sistemet e monitorimit të nxënësve<br>- Vlerësimi në bazë shkolle<br>- Provimet<br>- Sistemet e informacionit për menaxhimin e sistemit<br>- Sistemet e informacionit për menaxhimin e shkollës<br>- Ekipet ndërkombëtare të vlerësimit<br>- Inspektimi i shkollës<br>- Vlerësimi i mësuesit<br>- Auditimi i shkollës<br>- Monitorimi dhe vlerësimi si pjesë e mësimdhënies<br>- Vlerësim i programit | |

| | |
|---|---|
| | - Efektshmëria e shkollës |
| **JavaeIV** | **Konceptimi i procesit të vlerësimit**<br>- Hapat e procesit të vlerësimit<br>- Kuptimi i problemit të vlerësimit<br>- Planifikimi i vlerësimit<br>- Mbledhja e të dhënave<br>- Aaliza e të dhënave<br>- Raportimi i rezultateve të vlerësimit |
| **Javae V** | **Vlerësimi i nxënësve**<br>- Funksionet e vlerësimit të nxënësve<br>- Kritere për vlerësimin e nxënësve<br>- Instrumente të vlerësimit të nxënësve<br>- Probleme të vlerësimit të nxënësve |
| **Javae VI** | **Vlerësimi i mësuesve**<br>- Funksione të vlerësimit të mësuesve<br>- Instrumente dhe procedura për vlerësimin e mësuesve<br>- Probleme të vlerësimit të mësuesve |
| **Javae VII** | **Vlerësimi i programeve**<br>- Kuptimi i vlerësimit të programit<br>- Standarde të vlerësimit të programeve<br>- Vlerësimi i programeve arsimore<br>- Vlerësimi i kurrikulave |
| **Javae VIII** | - Vlerësimi i programeve arsimore<br>- Vlerësimi i kurrikulave |
| **JavaeIX** | **Vlerësimi i veprimtarisë së shkollës**<br>- Vlerësimi si mjet për planifikimin dhe menaxhimin e shkollës<br>- |
| **Javae X** | - Vlerësimi si mjet për përmirësimin e shkollës<br>- Vlerësimi i brendshëm i shkollës |
| **Javae XI** | - Vlerësimi i jashtëm i shkollës<br>- Kombinimi i vlerësimit të brendshëm me vlerësimin e jashtëm |
| **Javae XII** | **Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit arsimor**<br>- EMIS: objektivat në nivel vendi<br>- EMIS: procesi dhe burimet njerëzore dhe materiale<br>- Evidenca e të dhënave arsimore |
| **Javae XIII** | - Treguesit për monitorimin e sistemit arsimor<br>- Monitorimi i standardeve të arsimit |
| **Javae XIV** | - Si i përdorin shkollat të dhënat e vlerësimit<br>- Analiza e të dhënave të performancës |
| **Javae XV** | - Përdorimi i të dhënave për të personalizuar të nxënët dhe mësimdhënien<br>Përdorimi i të dhënave për zhvillimin e shkollës |
| | **TEMAT E SEMINAREVE** |

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel: +355 42 247 598, www.uart.edu.al

| | |
|---|---|
| **JavaeI** | **Vlerësimi i nevojave në arsim - studim rasti** |
| **JavaeII** | Vlerësimi i nevojave të nxënësve me përparim të dobët-rasti i një shkolle |
| **JavaeIII** | Vlerësimi i nevojave të mësuesve për zhvillim profesional- rasti i një shkolle |
| **JavaeIV** | Vlerësim i nevojave të zhvillimit të shkollës-rasti i një shkolle |
| **Javae V** | Vlerësim i nevojave për përfshirjen e prindërve në shkollë-rasti i një shkolle |
| **Javae VI** | Vlerësimi i brendshëm i shkollës<br>Vlerësimi i jashtëm i shkollës |
| **Javae VII** | |
| **Javae VIII** | **Vlerësimi i nxënësve – studim rasti** |
| **JavaeIX** | Përdorimi i testeve për vlerësimin e nxënësve |
| **Javae X** | Përdorimi i dosjes për vlerësimin e nxënësit |
| **Javae XI** | Përdorimi i notës |
| **Javae XII** | Vlerësimi i detyrave të shtëpisë dhe projekteve |
| **Javae XIII** | Vleresimi rezultateve provimit lirimit dhe matures |
| **Javae XIV** | **Dokument i politikës së vlerësimit të veprimtarisë së shkollës**<br>Politika e vlerësimit të nxënësve (rasti i një shkolle) |
| **Javae XV** | Politika e vlerësimit të shkollës (rasti i një shkolle) |

**FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE**

**FREKUENTIMI**

1. Studenti duhet të frekuentojë jo më pak se 75% tëlëndës në auditor.
2. Nëse frekuentimi i studentit është më pak se 75% e lëndës në një vit akademik, atëherë ai detyrohet të kalojë në frekuentimin e saj në vitin pasardhës sipas rregullores së ciklit të parë të studimeve të UART.

**KONTROLLI I VAZHDUESHËMDO TË NXIRRET NGA KËTO ELEMENTE:**

**a)** Pjesëmarrje aktive në orën e mësimit: **10%**
**b)** Puna e pavarur krijuese: **20%**
**c)** Detyrat e kursit: **20%**
**d)** Projektet e kursit: **20%**
**e)** Provimi përfundimtar: **30%**

**SISTEMI I VLERËSIMIT TË STUDENTIT**

| Nota | Në % | Përkufizimi |
|---|---|---|
| 10 | 91-100% | SHKËLQYESHËM |
| 9 | 81-90% | SHUMË MIRË |
| 8 | 71-80% | MIRË |
| 7 | 61-70% | KËNAQSHËM |
| 6 | 51-60% | MJAFTUESHËM |
| 5 | 40-50% | DOBËT |
| 4 | 00-39% | KEQ |

**LITERATURA**

| **Literaturë bazë e detyrueshme** |
|---|
| 1. Dr. Manjola Tërshana *Vlerësimi në arsim (paketë me leksione)*. Tiranë 2020.<br>2. Cees Glas, JAAP SCHEERENS, and Sally M. Thomas, (2007) *Educational Evaluation, Assessment and Monitoring: A systematic Approach*, Tyler & Francis.<br>3. Nevo, D. (1995) *School-Based Evaluation: A dialogue for school improvement.* Pergamon. |
| **Literatura ndihmëse** |
| 1. Agjencia e sigurimit te cilesise se arsimit parauniversitar<br>2. IZHA, Korniza e vlerësimit, 2015.<br>3. Karta e performancës, 2014.<br>4. Piket e dosjes se mesuesit 2021<br>5. Mesues.arsimi.gov.al2021<br>6. Portali mesues per Shqiperine 2021, program orientues |
| **Vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës, nëse ka.** |
| |

**Pedagogu i Lëndës**

**Dr. Manjola Tërshana**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel: +355 42 247 598, www.uart.edu.al

**DEPARTAMENTI AKTRIM & TEORI**

**PROGRAMI I STUDIMIT " FORMIMI I VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKOPEDAGOGJIKE PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË RREGULLUAR TË MËSUESIT"**

**PROGRAMII LËNDËS**

**PSIKOLOGJI ZHVILLIMI**

**Viti akademik 2023-2024**

**Titullari i Lëndës**

**Prof. Ass. Elida Rapti**

**Përgjegjësi i Njësisë Bazë**

**Prof.Gazmend Gjoka**

**Dekani**

**Prof. Petrit Malaj**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK
UNIVERSITETI I ARTEVE
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel: +355 42 247 598, www.uart.edu.al

# PARAQITJAE LËNDËSNGAPEDAGOGU

| | |
|---|---|
| NUMRI I KREDITEVE | 4 ECTS |
| NUMRI I ORËVE MËSIMORE NË KLASË | 45 ORË |
| FORMA E MËSIMDHËNIES | LEKSIONE/SEMINSRE |
| VITI AKADEMIK | 2023-2024 |
| SEMESTRI KUR ZHVILLOHET | I PARË- VITI II |
| LLOJI I LËNDËS | E DETYRUESHME |
| PROGRAMI I STUDIMIT | AKTRIM &MESUESI |
| ADRESA ELEKTRONIKE E TITULLARIT/E PEDAGOGUT TË LËNDËS | elidarapti@yahoo.com |
| KODI I ETIKËS | Në tërësi VSA Nr. 23. Datë 06.03.2020, Mbi miratim e Kodit tëEtikësnë UART |

## PËRMBLEDHJA E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT

**Objektivat e lëndës:**
(janë synimet që lënda tenton të arrijë në përfundim të saj, të cilat ndahet në njohuritë dhe kompetencat që studenti pritet të përvetësojë në përfundim të lëndës.)

- Të njohi etapat e ☺zzhvillimit moshor te individi përgjatë rritjes .
- Të kuptojë se cilat janë disa prej teorive kryesore të zhvillimit njerëzor dhe disa teori të tjera që lidhen me to.
- Të njohi karakteristikat që ndodhin gjatë zhvillimit fizik,kognitiv e psikosocial në moshën parashollore, fëmijërisë së mesme dhe adoleshencës .
- Të identifikojë faktorët psikosocial që çojnë në përfshirjen e adoleshentëve në situata të rrezikshme përgjatë zhvillimit moshor
- Të njohin karakteristikat psikologjike të moshës për të mundësuar një mësimdhënie dhe edukim efektiv ne proçesin e të nxënit në shkollë

**Qëllimi i lëndës:**
Qëllimi i lëndës është të ndihmojë studentin për të njohur teoritë e zhvillimit moshor shkollor, të kuptojnë logjikën dhe zbatimin e tyre dhe të arrijnë të bëjnë evidentimin e tyre në zhvillim , në sjellje apo demostrime të ndryshme gjatë performancës së nxënësit.

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel: +355 42 247 598, www.uart.edu.al

# KONCEPTET THEMELORE DHE TERMAT BAZË MBI TË CILAT NDËRTOHET LËNDA

Konceptet kryesore që trajtohen në këtë kurs janë

- Teoria e zhvillimit Xhon Loke,
- Teoria e ,Zhan Zhak Ruso.
- Teoria psikoseksuale e Frojdit
- Teoria e zhvillimit psikosocial të Eriksonit,
- Teoria konjitiviste e Piazhes
- Teoria e proçesimit të informacionit,
- Teoria sociale e të mësuarit,
- Teoritë humaniste.
- Koncepti qelizës
- Koncepti genit
- Koncepti fenotipit
- Koncepti të menduarit paraoperacional
- Koncepti Stadeve paraoperacional
- Koncepti imazhit mendor
- Koncepti bilinguizmit
- Konceptit për veten dhe gjinin
- Formimi i roleve gjinore.
- Stilet e prindërimit.
- Efekti i divorcit tek fëmijët.
- Loja dhe funksionet e lojës.
- Koncepti obezitetit
- Stadet e operacioneve konkrete
- Koncepti për vehten.
- Koncepti Vetëvlersimit
- Koncepti zhvillimit moral
- Teoria e Kohlbergut për zhvillimin moral
- Koncepti i shoqërisë te fëmijët.
- Formimi grupit të moshatarëve.
- Koncepti Konformizmi ndaj grupit
- Abuzimi psikologjik i fëmijës
- Koncepti Pubertetit.
- Koncepti Maturimit të shpejt dhe Maturimi i vonë.
- Koncepti Anoreksis nervore.
- Sjellja seksuale në adoleshencë
- Stadi i operacioneve formale .
- Torisa e proçesimit të informacionit.
- Koncepti Egocentrizmit të adoleshentëve
- Koncepti identitetit.

- Ndikimet në proçesin e formimit të identitetit.
- Koncepti identitetit sipas Erikson dhe Marcias
- Koncepti Krahasimit social.
- Sjellja e riskut në adoleshenncë
- Koncepti depresioni dhe vetëvrasja në adoleshencë

## TEMAT E LËNDËS

(Janë shpjegim rreth një paragraf i çdo teme të leksionit sipas javëve shoqëruar me literaturën përkatëse.)

| PERIUDHA | TEMA |
|---|---|
| SEMESTRI I PARË | |
| **Java I** | **Objekti dhe historia e psikologjisë së zhvillimit**<br>Analizon karakteristikat e zhvillimit dhe konceptet historike që lidhen me fëmijërinë. Trajton fëmijët si miniaturë e të rriturve, dhe jep konceptimet filozofike lidhur me fëmijërinë. Pikpamjet e Loke,fëmijët si tabula rasa nga Zhan Zhak Ruso ,fëmijët si qënie aktive.<br>. |
| **Java II** | **Teoritë për zhvillimin njerëzor**<br>Trajton teoritë psikoanalitike psikoseksuale të Frojdit. Teoritë e zhvillimit psikosocial të Eriksonit, Teoria konjitiviste e Piazhes për zhvillimin me stadet e zhvillimit konjitiv.Teoria e proçesimit të informacionit,teoria bihevioriste,teoria sociale e të mësuarit,teoria e vetefikasitetit,teoritë humaniste. |
| **Java III** | **Bazat biologjike të zhvillimit**<br>Si kryhet riprodhimi njerzor .Qelizat seksuale.Kur ndodh konceptimi?si ndodh që të konceptohen dhe të lindin fëmijë binjak?.Infertiliteti.Mekanizmat e trashëgimisë.Kromozonet,genet,dhe proteinat.GMjedisi dhe problemet psikologjike .Fenotipi ,rezultat i ndërveprimit të geneve me mjedisin |
| **Java IV** | **Zhvillimi fizik në moshën parashkollore**<br>Proporcionet e trupit,pesha,lartësia dhe pamja,ndryshimet strukturore.Zhvillimi i trurit.Shëndeti në moshën parashkollore.Zhvillimi motorik.Shprehit e mëdha motorike,shpehitë fine motorike |
| **Java V** | **Zhvillimi kognitiv në moshën parashkollore**<br>Stadi paraoperacional i Piazhe. Epërsit dhe kufizimet e të menduarit para operacional . Simbolet dhe shenjat imitimi i vonuar, loja simbolike, vizatimi. Imazhet mendore .Teoria e proçesimit të informacionit,vëmëndja,kujtesa |
| **Java VI** | **Zhvillimi gjuhësor në moshën parashkollore**<br>Zhvillimi gjuhësor në moshën parashkollore.Një sintezë për gjuhën dhe komponentët e saj. Konceptet dhe fjalët e reja,konteksti social i gjuhës monitorimi |

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel: +355 42 247 598, www.uart.edu.al

| | |
|---|---|
| | i mesazhit Komunikimi, bilinguizmi...si përvetësohet gjuha? |
| **Java VII** | **Zhvillimi psikosocial në moshën parashkollore**<br>Zhvillimi i konceptit për veten. Koncepti për gjinin. Formimi i roleve gjinore. Familja dhe fëmija. Stilet e prindërimit. Efekti i divorcit tek fëmijët. Marrrëdhënia me moshatarët dhe loja. Funksionet e lojës. Tipat e lojës Fëmijët parashkollor dhe stresi. |
| **Java VIII** | **Zhvillimi fizik në fëmijërinë e mesme**<br>Karakteristikat e zhvillimit fizik.Diferencat në zhvillimin fizik mes vajzave.Zhvillimi motorik.Rritja në përmasat e trupit.Kordinimi i shprehive të mëdha motorike. Diferencat gjinore në shprehit motorike. Koha e reagimit.Shëndeti.Obeziteti |
| **Java IX** | **Zhvillimi kognitiv në fëmijërinë e mesme**<br>Pikpamja e Piazhes. Karakteristikat e stadit të operacioneve konkrete.Zhvillimi kognitiv sipas teorisë së proçesimit të informacionit.Stilet konjitive |
| **Java X** | **Zhvillimi psikosocial në fëmijërinë e mesme**<br>Zhvillimi i konceptit për veten,vetëvlersimi. Zhvillimi i konjicionit social. Zhvillimi i konjicionit moral. Shpjegimi prej Pjazhes i zhvillimit moral .Teoria e Kohlbergut për zhvillimin moral. |
| **Java XI** | **Marrëdhëniet sociale në fëmijërinë e mesme**<br>Koncepti i shoqërisë te fëmijët. Funksionet e shoqërisë. Prirja e formimit të grupit të moshatarëve. Statuset brënda grupit.Konformizmi ndaj grupit. Familja dhe fëmija. Marrëdhëniet prind-fëmij në fëmijërinë e mesme.Abuzimi psikologjik i fëmijës |
| **Java XII** | **Zhvillimi fizik në moshën e adoleshencës**<br>Zhvillimi fizikI vrullshëm në moshën e adoleshencës. Puberteti. Efektet psikologjike të zhvillimit fizik.Maturimi i shpejt. Maturimi i vonë. Reagimi i vajzave ndaj menarkesë. Anoreksia nervore. Bulimia nervore. Sjellja seksuale në adoleshencë |
| **Java XIII** | **Zvillimi kognitiv në moshën e adoleshencës**<br>Piazheja stadi i operacioneve formale .Zhvillimi konjitiv në adoleshencë sipas teorisë së proçesimit të informacionit. Ndryshimet në përmbajtjen e mendimit të adoleshentëve. Egzaminimi i botës dhe i familjes. Egocentrizmi i adoleshentëve. |
| **Java XIV** | **Zhvillimi psikosocial në moshën e adoleshencës**<br>Zhvillimi i identitetit. Ndikimet në proçesin e formimit të identitetit. Konceptet e Erikson dhe Marcias për identitetin. Diferencat gjinore në lidhje me identitetin. |
| **Java XV** | **Sjelljet agresive në moshën e adoleshencës**<br>Adoleshenti dhe familja.Adoleshenti dhe moshatarët.Krahasimi social.Shoqëritë me seksin e kundërt.Grupet e adoleshentëve të vetmuar.Përfshirja e adoleshëntëve në sjellje rrisku.Depresioni dhe vetëvrasja në adoleshencë |
| | **PLANI SEMINAREVE** |
| **Java I** | Njohja me programin dhe udhëzime për seminaret dhe detyrën e kursit |
| **Java II** | Rëndësia e teorive të zhvillimit njerëzor. |

| | |
|---|---|
| **Java III** | Mekanizmat e trashëgimisë dhe rëndësia praktike e tyre |
| **Java IV** | Rëndësia e lojës në zhvillimin fizik në moshën parashkollore |
| **Java V** | Rëndësia e elementëve që reflektojnë përfaqsimin mendor në moshën parashkollore |
| **Java VI** | Gjuha si simbol i identitetit social në moshën parashkollore |
| **Java VII** | Rëndësia e formimit të roleve gjinore në moshën parashkollore |
| **Java VIII** | Qëndrimet e sotme në lidhje me lojën imagjinare në moshën parashkollore |
| **Java IX** | Rëndësia praktike e teorisë së procesimit të informacionit |
| **Java X** | Kognicioni social dhe rëndësia e zhvillimit të tij në fëmijërinë e mesme |
| **Java XI** | Marrëdhëniet me moshatarët në fëmijërinë e mesme |
| **Java XII** | Efektet psikologjike të zhvillimit fizik në moshën e adoleshencës |
| **Java XIII** | Ndikimi i shoqërisë në sjelljet e adoleshentëve. |
| **Java XIV** | Prezantimi i punimeve |
| **Java XV** | Prezantimi punimeve |

## FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

## KONTROLLI I VAZHDUESHËMDO TË NXIRRET NGA KËTO ELEMENTE:

**a)** Pjesëmarrje aktive në orën e mësimit: **10%**
**b)** Detyrat e kursit: **20%**
**c)** Provim i ndermjetëm **20%**
**d)** Provimi përfundimtar:**50%**

## SISTEMI I VLERËSIMIT TË STUDENTIT

| Nota | Në % | Përkufizimi |
|---|---|---|
| 10 | 91-100% | SHKËLQYESHËM |
| 9 | 81-90% | SHUMË MIRË |
| 8 | 71-80% | MIRË |
| 7 | 61-7 | KËNAQSHËM |
| 6 | 1-60% | MJAFTUESHËM |
| 5 | 40-50% | DOBËT |
| 4 | 00-39% | KEQ |

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel: +355 42 247 598, www.uart.edu.al

# LITERATURA

| Literaturë bazë e detyrueshme |
|---|
| 1. Click, S. & Parker, J.(2012) *Caring for school age children,* Cengage Learning, version online, fq. 17-30; 63-77; 88-92<br>2. Karaj, T (2002) *Psikologjia e zhvillimit të fëmijës* Ermal, fq. 22-76, 82-102, 119-134 |
| **Literaturë e rekomanduar** |
| 1. Materiale nga burime autentike: Piaget, Vygotsky, Erikson, Bandura, Gagne., gjithsej 120 faqe (sipas kërkesës së studentit).<br>1. ëëë.psychologytoday.com/topics/child-development - burlme interneti |
| **Vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës, nëse ka.** |
| (hapësira ku pedagogu parashtron mendime, rekomandime, vërejtje, kufizime, rezerva që lidhen me zhvillimin e lëndës në fjalë gjatë vitit akademik, nëse ka, si edhe elementet e kodit të etikës të miratuar me VSA Nr. 23. Datë 06.03.2020) |

**Pedagogu i Lëndës**

**Prof. Ass.dr Elida Rapti**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel: +355 42 247 598, www.uart.edu.al

**DEPARTAMENTI AKTRIM & TEORI**

# PROGRAMI I STUDIMIT "FORMIMI VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKOPEDAGOGJIKE PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË RREGULLUAR TË MËSUESIT"

## PROGRAMII LËNDËS TEORI TË NXËNI DHE MENAXHIM KLASE

**Viti akademik 2023-2024**

**Titullari i Lëndës**
**Dr. Ndriçim Mehmeti**

**Përgjegjësi i Njësisë Bazë**

**Dekani**
**Prof. Petrit MALAJ**

REPUBLIKA E SHQIPERISE FAKULTETI I ARTIT SKENIK UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË

# PARAQITJAE LËNDËSNGAPEDAGOGU

| | |
|---|---|
| NUMRI I KREDITEVE | 6 ECTS |
| NUMRI I ORËVE MËSIMORE NË KLASË | 75 ORË |
| FORMA E MËSIMDHËNIES | Leksion/Seminar |
| VITI AKADEMIK | 2023-2024 |
| SEMESTRI KUR ZHVILLOHET | I PARË |
| LLOJI I LËNDËS | E DETYRUESHME |
| PROGRAMI I STUDIMIT | Formimi vazhduar në Fushen Psiko - Pedagogjike për Profesionin e Rregulluar të Mësuesit" |
| ADRESA ELEKTRONIKE E TITULLARIT/E PEDAGOGUT TË LËNDËS | cimmehmeti@yahoo.com |
| KODI I ETIKËS | Në tërësi VSA Nr. 23. Datë 06.03.2020, Mbi miratim e Kodit tëEtikësnë UART |

## PËRMBLEDHJA E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT

**Objektivat e lëndës:**
Përvetësimin aktiv dhe të qëndrueshëm të njohurive shkencore, të cilat kanë të bëjnë me teknikat bashkëkohore në procesin e mësimdhënies dhe të nxënit e njohurive, Studentët e masterit të marrin informacion shkencor për rritjen e cilësisë së të mësuarit dhe të shkallës së mjeshtërisë pedagogjike polivalente; Studentët të njihen me përvojat e universiteteve homologe europiane rreth teknologjisë teorike e praktike në procesin dinamik dhe kompleks të menaxhimit të klasës, tëtë mësuarit, rreth teknikave të arsimimit, të planifikimit të mësimit e të strategjive themelore që duhet të përdorë mësuesi në procesin e mësimit

**Qëllimi i lëndës:**
Qëllimi i lëndës është që studenti të fitojë aftësi dhe kompetenca të veçanta në mënyrë që të fitojë:

- Njohuri për strategjitë e të nxënit dhe procedurat e organizimit të të nxënit.
- Aftësi për të dalluar strategjitë e ndryshe të të nxënit, për të menaxhuar kohën dhe organizuar rutinën pozitive, për të zgjidhur problemet gjatë të nxënit dhe studimit.

# KONCEPTET THEMELORE DHE TERMAT BAZË MBI TË CILAT NDËRTOHET LËNDA

| |
|---|
| 1. Lënda e teorisë të nxënit, ka në themel zhvillimin e teorive të të nxënit, prej kohërave më të lashta e deri në ditët tona.<br>2.Evoluimi i konceptit dhe teorive të nxënit.<br>3. Pse të nxënit mbetet një temë e debatueshme, mes filozofëve, sociologëve, studiuesve të arsimit dhe publikut t gjerë<br>4. Mënyrat sesi studentët e mësuesisë, do të konceptojnë dhe të nxënit për nxënësit dhe metodat që ata do të përdorin për nxitjen dhe motivimin drejt të nxënit bashkëkohor |

## TEMAT E LËNDËS

| PERIUDHA | TEMA |
|---|---|
| SEMESTRI I PARË | |
| **JavaeI** | Teoritë e të nxënit. Njohja me teoritë kryesore të të nxënit<br>S.Garo: Teoria e mësimdhenies. Fq.2-18 |
| **JavaeII** | Biheviorizmi, konjitivizmi, konstruktivizmi dhe dallimet midis tyre.<br>Kur u zhvilluan këto teori, të përbahskëtt dhe ndryshimet. |
| **JavaeIII** | Të nxënit si proces..<br>Procesi i te nxënit, fazat në të cilat zhvillohet terreni ku zhvillohen.<br>S.Garo: Teoria e mësimdhënies. Fq.18-31 |
| **JavaeIV** | Të nxënit formal dhe informal, të nxënit në kontekst<br>Çfarë do të thotë të nxënit formal dhe informal. Si zhvillohen në ditët tona dhe cilat janë përparësitë e të nxënit formal dhe informal.<br>G.Sula: Të nxënët. F 18 27-27 |
| **Javae V** | Nxënësit dhe problemet me të mësuarit. Diagnoza mësimore. Problemet me të cilat përballohen nxënësit. Analiza që i bën mësuesi kësaj problematike<br>P.Senge: Pesë disiplinat.F.75 – 115 |
| **Javae VI** | Qëndrimet, shpërblimet .<br>Temple, Charles etj. (2006). Strategji të mësimdhënies për klasat mendimtare. Tiranë, fq. 14-42 |
| **Javae VII** | Krijimtaria. Shprehitë krijuese<br>Norwegian Embassy\ Robert F. Biehler – Jack Snoëman. 2004. Psikologji e zbatuar në mësimdhënie," Institutii Studimeve Pedagogjike" Tiranë, |
| **Javae VIII** | Konjitivizmi, objektivat.<br>Temple, Charles etj. (2006). Strategji të mësimdhënies për klasat mendimtare. Tiranë, Prishtinë: Qendra për Arsim Demokratik & Qendra për Arsim e Kosovës. |
| **JavaeIX** | Të nxënit si inteligjencë.<br>Pse të nxënit është inteligjencë dhe a na shërben inteligjenca në fushën e të nxënit |

| | |
|---|---|
| | Metodologji e mësimdhënies.Tiranë: PEG, fq. 22-53 |
| **Javae X** | Inteligjencat e shumëfishta, vështirësitë në të nxënë<br>Shfaqja e inteligjencave të shumëfishta tek nxënsit, shfrytëzimi i tyre në fushën e të nxënit.<br>Basic Education Program.2011. Vlerësimi formativ, fq. 35-52. |
| **Javae XI** | Konceptet themelore mbi. të nxënit<br>Konceptet mbi të nxënit, zbatimi i tyre në terrenin praktikë në klasë<br>Grup autorësh (2005). Mësimdhënia me në qendër nxënësin. Tiranë: QTKA., fq. 26-45. |
| **Javae XII** | Modelet Mendore, përshtatja.<br>Modelet mendore dhe qasja e mësuesit në to<br>Gaxhiqi, B. (2019). "Mësimi i diferencuar në nivele të ndryshme të vështirësisë në mësimnxënie". Shtëpia botuese "Dita", Tiranë, fq. 42-64. |
| **Javae XIII** | Zhan Piazhe. Metakonjicioni<br>Zhan Piazhe, teoria mbi të nxnëit dhe ndrsyhimet që solli në mësimdhënie.<br>Musai, Bardhyl (2003). Metodologji e përgjithshme e mësimdhënies. Tiranë. PEGI, fq. 62-78. |
| **Javae XIV** | Konstruktivizmi.<br>Njohja me teorinë kontruktiviste, fillesat e saj dhe si studiohet ajo sot.<br>Gaxhiqi, B. (2019). "Mësimi i diferencuar në nivele të ndryshme të vështirësisë në mësimnxënie". Shtëpia botuese "Dita", Tiranë, fq.31-54 |
| **Javae XV** | Filozofia konstruktiviste.<br>Si u zhvillua filozofia konstruktivite dhe përfaqësuesit e saj.<br>Musai, Bardhyl (1999): Psikologji edukimi. Tiranë. PEGI, fq. 47-69 |
| **SEMESTRI I DYTË** | |
| **JavaeI** | Skemat individuale në ndërtimin e dijeve.<br>Ndërtimi i skemave të të nxënit brenda një programi mësimor.<br>Basic Education Program.2011. Vlerësimi formative, 14-25 |
| **JavaeII** | Vizioni i përbashkët në fushën e të nxënit.<br>Hartimi dhe zbatimi i një vizioni të përbashkët për të nxënësit në një vit shkollor.<br>Musai, Bardhyl (2003). Metodologji e përgjithshme e mësimdhënies. Tiranë:PEGI. Fq. 31-67 |
| **JavaeIII** | Metakonjicioni. |

| | |
|---|---|
| | Njohja me metakonjitivizmin si nje teori e të nxënit të shek.. XIX<br>Skinner, B.F. (1957). Verbal behavior. Engleëood Cliffs, NJ: Prentice-Hall, fq. 14-28 |
| **Java e IV** | Instrumentet dhe modelet mendore<br>Modelet mendore dhe instrumentey zbatuese të tyre<br>Gaxhiqi, B. (2019). "Mësimi i diferencuar në nivele të ndryshme të vështirësisë në mësimnxënie". Shtëpia botuese "Dita", Tiranë |
| **Javae V** | Të mësuarit sistemik.<br>Çfarë është të mësuarit sistemik dhe rëndësia që ka në ditët tona.<br>Skinner, B.F. (1957). Verbal behavior. Engleëood Cliffs, NJ: Prentice-Hall, fq. 16-39. |
| **Javae VI** | Vështirësitë në nxënie. Faktorët frenues.<br>Njohja me vështirësitë në të të nxënë. Faktorët frenues dhe is duhet ti përgjigjet mësuesi këtyre faktorëve?<br>Mills, John A., Control: A History of Behavioral Psychology, Paperback Edition, Neë York University Press 2000., fq. 14-31 |
| **Javae VII** | Qasja në bazë situate.<br>Pozita e mësuesit në situatat e krijuar të të nxënit në klasë<br>Temple, Charles etj. (2006). Strategji të mësimdhënies për klasat mendimtare. Tiranë, fq. 42-64. |
| **Javae VIII** | Ndërtimi i ideve të reja.<br>Hartimi i stratgjisë për ndërtimin e ideve të reja në bashkëpunim me nxënësin. |
| **JavaeIX** | Mësimdhënia dhe mësim nxënia moderne.<br>Si konceptohet në ditët tona mësimdhënia moderne<br>Mills, John A., Control: A History of Behavioral Psychology, Paperback Edition, New York University Press 2000., fq. 14-31 |
| **Javae X** | Filozofia e të nxënit sipas P. Senge<br>Senge dhe të nxënit sipas konceptit të tij<br>P.Senge: Pesë disiplinat.F.75 – 115 |
| **Javae XI** | Të nxësit sipas Djuit dhe Montesorit<br>Teoritë e Djuit dhe Mosntesorit për të nxënit. Si e ndryshuan të nxënit këto teori.<br>Grup autorësh. (2013). Vlerësimi në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësit. Prishtinë, fq. 64-72 |
| **Javae XII** | Selio dhe të nxënit<br>Njohja me sociologun e njohur të viteve 60, të shek.. XX, Selio dhe teoria e tij mbi të nxënit.<br>Mills, John A., Control: A History of Behavioral Psychology, Paperback Edition, New York University Press 2000, fq. 43-65 |
| **Javae XIII** | Inteligjencat e shumëfishat të Gardnerit<br>Njohja me inteligjencat e Gardnerit dhe rëndësia e tyre në të nxënit e një fëmije. |

| | |
|---|---|
| | Musai, Bardhyl (1999): Psikologji edukimi. Tiranë. PEGI, fq. 35-62. |
| **Javae XIV** | Koncepti i të nxënit dhe teknologjia në ditët e sotme<br>Konceptimi i të nxënit, roli i teknologjisë dhe motivimi i nxënësve.<br>Grup autorësh. (2013). Vlerësimi në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësit. Prishtinë, fq. 74-89. |
| **Javae XV** | Përsëritje e lëndës. |

## FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

### FREKUENTIMI

1. Studenti duhet të frekuentojë jo më pak se 75% të lëndës në auditor.
2. Nëse frekuentimi i studentit është më pak se 75% e lëndës në një vit akademik, atëherë ai detyrohet të kalojë në frekuentimin e saj në vitin pasardhës sipas rregullores së ciklit të parë të studimeve të UART.

### KONTROLLI I VAZHDUESHËMDO TË NXIRRET NGA KËTO ELEMENTE:

**a)** Pjesëmarrje aktive në orën e mësimit: 10%
**b)** Puna e pavarur krijuese: 20%
**c)** Detyrat e kursit: 20%
**d)** Projektet e kursit: 20%
**e)** Provimi përfundimtar: 30%

SISTEMI I VLERËSIMIT TË STUDENTIT

| Nota | Në % | Përkufizimi |
|---|---|---|
| 10 | 91-100% | SHKËLQYESHËM |
| 9 | 81-90% | SHUMË MIRË |
| 8 | 71-80% | MIRË |
| 7 | 61-70% | KËNAQSHËM |
| 6 | 51-60% | MJAFTUESHËM |
| 5 | 40-50% | DOBËT |
| 4 | 00-39% | KEQ |

## LITERATURA

**Literaturë bazë e detyrueshme**

1. Basic Education Program.2011. Vlerësimi formativ.
2. Temple, Charles etj. (2006). Strategji të mësimdhënies për klasat mendimtare. Tiranë, Prishtinë: Qendra për Arsim Demokratik & Qendra për Arsim e Kosovës.
3. Grup autorësh (2005). Mësimdhënia me në qendër nxënësin. Tiranë: QTKA.
4. Biehler, Robert F.& Snowman, Jack (2004). Psikologjia e zbatuar në mësimdhënie. Tiranë: Instituti i Studimeve Pedagogjike.

5. Musai, Bardhyl (2003). Metodologji e përgjithshme e mësimdhënies. Tiranë:PEGI.
6. Garo, Sofokli (2008). Mësimdhënia bashkëkohore. Tiranë: Botimet Toena.f.138- 144. Garo, Sofokli (2002). Sfidat e mësimdhënies.Tiranë: Erik-Botime.
7. Musai, Bardhyl (1999): Psikologji edukimi. Tiranë. PEGI
8. Gaxhiqi, B. (2019). "Mësimi i diferencuar në nivele të ndryshme të vështirësisë në mësimnxënie". Shtëpia botuese "Dita", Tiranë
9. Garuli, L. (2018). "Çrregullimet e të nxënit", Tiranë.
10. Karaj. Dh, Menaxhimi i Klasës
11. P.Senge: Pesë disiplinat.F.75 – 115

Literaturë e rekomanduar

1. Norwegian Embassy\ Robert F. Biehler – Jack Snoëman. 2004. Psikologji e zbatuar në mësimdhënie," Institutii Studimeve Pedagogjike" Tiranë, Bardhyl Musai. 2003.
2. Metodologji e mësimdhënies.Tiranë: PEG
3. Grup autorësh. (2013). Vlerësimi në funksion të zhvillimit të kopetencave të nxënësit. Prishtinë.
4. Mills, John A., Control: A History of Behavioral Psychology, Paperback Edition, New York University Press 2000.
5. Skinner, B.F. (1957). Verbal behavior. Englewood Cliffs, NJ: Prentice-Hall.
6. Skinner, B.F. (1969). Contingencies of reinforcement: a theoretical analysis. New York: Appleton-Century-Crofts

**Vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës, nëse ka.**

**Nuk ka**

**Pedagogu i Lëndës**

**Dr. Ndriçim Mehmeti**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel: +355 42 247 598, www.uart.edu.al

**DEPARTAMENTI AKTRIM & TEORI**

**PROGRAMI STUDIMIT "FORMIMI VAZHDUAR NE FUSHEN PSIKO-PEDAGOGJIKE PER USHTRIMIN E PROFESIONIT TE RREGULLUAR TE MESUESIT "**

# PROGRAMI I LËNDËS
# METODOLOGJI E MËSIMDHËNIES

**Viti akademik 2023-2024**

**Titullari i Lëndës**

**Dr. Majlinda HALA**

**Përgjegjësi i Njësisë Bazë**

**Prof.Gazmend Gjoka**

**Dekani**

**Prof. Petrit MALAJ**

## PARAQITJA E LËNDËS NGA PEDAGOGU

| | |
|---|---|
| NUMRI I KREDITEVE | 6 ECTS |
| NUMRI I ORËVE MËSIMORE NË KLASË | 75 ORË |
| FORMA E MËSIMDHËNIES | LEKSION |
| VITI AKADEMIK | 2023-2024 |
| SEMESTRI KUR ZHVILLOHET | I PARË |
| LLOJI I LËNDËS | E DETYRUESHME |
| PROGRAMI I STUDIMIT | Formimi Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike për profesionin e Rregulluar të Mësuesit" |
| ADRESA ELEKTRONIKE E TITULLARIT/E PEDAGOGUT TË LËNDËS | majlindahala@gmail.com |
| KODI I ETIKËS | Në tërësi VSA Nr. 23. Datë 06.03.2020, Mbi miratim e Kodit të Etikës në UART |

## PËRMBLEDHJA E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT

**Përshkrimi i lëndës:**

Kjo lëndë përbëhet nga dy module të cilat trajtojnë përmbajtje pedagogjike që plotësojnë njëra – tjera dhe njohuritë e studentë për lëndën.

**Moduli 1: Metodat e mësimit**

Metodat e mësimit trajtohen përmes leksioneve me të gjithë elementet e tyre, duke filluar nga

- objektivat mësimorë,
- planifikimi i mësimor,
- zhvillimi i metodave ndërvepruese që nxitin të nxënët aktiv dhe deri te
- vlerësimi i nxënësve.

Ky modul ka për qëllim trajtimin dhe kuptimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Këto shprehi janë mjaft të rëndësishme, për të përgatitur qytetarët për shoqërinë e dijes, ku identifikohen shprehitë bazë

(tashmë të emërtuara kompetenca), që duhet të përpunojë shkolla. Ato përbëjnë një tërësi njohurish, shprehish dhe vlerash, që u nevojiten individëve për zhvillimin e tyre të gjithanshëm. Të gjitha këto duhet të zhvillohen nga K-12 dhe duhet të shërbejnë si bazë për të mësuar më tej si pjesë e të nxënit afatgjatë. Pjesë e këtyre njohurive e shprehive janë edhe ato të zgjidhjes së problemit, të përpunimit të informacionit, të të nxënit në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me të tjerët. Procesi i mësimdhënies dhe i të nxënit, që synon përmbushjen e cilësive të qytetarëve të shoqërisë së dijes me të gjitha shprehitë e mësipërme, në të gjitha vendet me arsim të zhvilluar, bazohet te konstruktivizmi.

**Moduli 2: Të menduarit kritik**

Ky modul ka për qëllim që të ofrojë bazat kryesore që u mundëson studentëve njohjen me fuqinë e mendimit kritik si një proces intelektual i disiplinuar në mënyrë aktive dhe mjeshtërore, i konceptualizimit, zbatimit, analizimit, sintetizimit dhe vlerësimit të informacionit të mbledhur prej vëzhgimit, përvojës, reflektimit arsyetimit dhe komunikimit, që më pas duhet të shërbejë, si një udhëheqës për bindje dhe veprim.
Në këtë kontekst, studentët, gjithashtu, jo vetëm do të njihen me trajtimin e gjërë të arsyetimit shkencor, vendosjen e theksit te vlerësimi i fakteve, kompetencave dhe besueshmëria, por do të kenë mundësi edhe elaburimin e formimit të mendimeve origjinale, të zgjedhurin në mënyrë racionale midis ideve konkuruese, zgjidhjes së problemeve dhe debatimit të ideve me përgjegjësi.

**Objektivat e lëndës:**

Gjatë studimit të lëndës, studenti zhvillon njohuri, aftësi dhe qëndrime. Ai/ajo:

- Përdor metodat më kryesore të mësimdhënies.
- Analizon karakteristikat kryesore të metodave të mësimdhënies.
- Evidenton rezultatet e studimeve sipas përvojave të ndryshme.
- Zbaton modelet moderne të mësimdhënies në sistemin tonë arsimor.
- Gjykon në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese të mësimdhënies.
- Zotëron shprehi kryesore të të menduarit kritik.
- Zhvillon dhe zbaton parimet e të nxënit aktiv dhe të menduarit kritik.

**Vlerësimi i studentit për lëndën**

Në fund të këtij programi studenti do të vlerësohet për:

- Planifikimin me kujdes të programit mësimor të lëndës sipas llojeve të planifikimit.
- Zbatimin e metodave dhe teknikave të ndryshme të mësimdhënies sipas strukturës ERR.

- Realizimin e planifikimeve të kurrikulës varësisht ciklit apo klasës.
- Zbatimin e modeleve të mësimdhënies në grup.
- Gjykimin në mënyrë të pavarur mbi modelet ekzistuese.
- Zotërimin e shprehive kryesore të të menduarit kritik.
- Zhvillimin dhe zbatimin e parimeve të nxënit aktiv dhe të menduarit kritik.

## KONCEPTET THEMELORE DHE TERMAT BAZË MBI TË CILAT NDËRTOHET LËNDA

***Konceptet themelore*** të cilat jepen nëpërmjet lëndës janë:

1. Mësuesi
2. Kurrikula
3. Programi mësimor
4. Metoda/teknika mësimdhënie
5. Struktura ERR
6. Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi
7. Planifikimi dhe llojet e tij
8. Vlerësimi dhe llojet e tij
9. Testi
10. Vlerësimi për të nxënë dhe i të nxënit
11. Mendimi kritik
12. Arsyetimi shkencor
13. Faktet
14. Kompetenca
15. Besueshmëri
16. Zgjidhja problemore
17. Argumenti
18. Kumti
19. Bindja
20. Etj.

## TEMAT E LËNDËS

| PERIUDHA | TEMA |
|---|---|
| **SEMESTRI I PARË** | |
| **Java e I** | Mësuesi, mësimdhënia dhe cilësitë e saj. Krijimtaria dhe zhvillimi i shprehive të të menduarit të nxënësit |
| **Java e II** | Dije profesionale të mësuesit. Kurrikulumi dhe modelet e tij |
| **Java e III** | Synimet,qëllimet,objektivat dhe rezultatet e të nxënit. |
| **Java e IV** | Planifikimi i mësimit |
| **Java e V** | Përdorimi i teknologjisë digjitale |
| **Java e VI** | Mësimdhënia për të menduarit e nivelit të lartë |
| **Java e VII** | Shprehitë e komunikimit të pyeturit dhe diskutimi |
| **Java e VIII** | Të nxënit në bashkëpunim dhe në bashkëveprim |
| **Java e IX** | Mësimdhënia sipas nevojave të nxënësve dhe menaxhimi i sjelljes. |
| **Java e X** | Vlerësimi i përparimit të nxënësve. Mësuesi si hulumtues |
| **Java e XI** | Shprehitë e të menduarit: Analiza, Krahasimi, Kategorizimi dhe klasifikimi, Identifikimi i shkakut dhe pasojës. Zgjidhja e problemeve Argumentimi bindës |
| **Java e XII** | Shprehitë e të menduarit:Vënia e vetes në pozitën e tjetrit Sinteza, Interpretimi, Vlerësimi,Komunikimi, Zbatimi |
| **Java e XIII** | Kurrikula dhe dokumentet e saj |
| **Java e XIV** | Planifikimi dhe llojet e tij |
| **Java e XV** | Vleresimi dhe llojet e tij |
| **SEMESTRI I DYTË** | |
| **Java e I** | Fuqia e të menduarit kritik dhe rëndësia e tij |
| **Java e II** | "Mjedisi" i të menduarit kritik |
| **Java e III** | Të kuptojmë argumentat (pjesa e I) |
| **Java e IV** | Të kuptojmë argumentat (pjesa e II) |
| **Java e V** | Arsyet për të besuar kur pretendimet kundërshtojnë njëra-tjetërn, ekspertët dhe |

| | |
|---|---|
| | provat. |
| **Java e VI** | Ekspertët dhe provat. |
| **Java e VII** | Arsyet për të dyshuar kur pretendimet kundërshtojnë njëra-tjetrën. |
| **Java e VIII** | Ekspertët dhe provat. |
| **Java e IX** | Arsyetimet e gabuara. |
| **Java e X** | Logjika e parashtrimit. |
| **Java e XI** | Arsyetimi deduktiv. |
| **Java e XII** | Logjika kategorike. |
| **Java e XIII** | Arsyetimi induktiv. |
| **Java e XIV** | Përsëritje |
| **Java e XV** | Test |

## FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

## FREKUENTIMI

1. Studenti duhet të frekuentojë jo më pak se 75% të lëndës në auditor.
2. Nëse frekuentimi i studentit është më pak se 75% e lëndës në një vit akademik, atëherë ai detyrohet të kalojë në frekuentimin e saj në vitin pasardhës sipas rregullores së ciklit të dytë të studimeve të UART.

## KONTROLLI I VAZHDUESHËM DO TË NXIRRET NGA KËTO ELEMENTE:

a) Pjesëmarrje aktive në orën e mësimit: **10%**
**b)** Puna e pavarur krijuese: **20%**
c) Detyrat e kursit: **20%**
d) Projektet e kursit: **20%**
e) Provimi përfundimtar: **30%**

## SISTEMI I VLERËSIMIT TË STUDENTIT

| Nota | Në % | Përkufizimi |
|---|---|---|
| 10 | 91-100% | SHKËLQYESHËM |
| 9 | 81-90% | SHUMË MIRË |
| 8 | 71-80% | MIRË |
| 7 | 61-70% | KËNAQSHËM |
| 6 | 51-60% | MJAFTUESHËM |
| 5 | 40-50% | DOBËT |
| 4 | 00-39% | KEQ |

## LITERATURA

**Literaturë bazë e detyrueshme**

1. Musai, B. (2014). CDE *Metodologji e mësimdhënies*, Tiranë. fq1-10, fq56-68,fq 71-73,fq 90-104,fq 130-135,fq 226-239, fq 278-303,fq330-338,fq 358-366, fq 399-405
2. Musai, B. përg (2005). *Mësimdhënia dhe të nxënit ndërveprues - Metoda për zhvillimin e të menduarit kritik.* Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik. Fq28-30,fq36-40,fq 45,fq47-49,fq53-55,fq59-63,fq 68-71,fq79-82,fq 84-86,fq 90-93,fq 95-98,fq105-109,fq113-116,fq 119-123, fq125-129,fq 136-140,fq 151-156,fq160-163,fq167- 171,fq 175-178,fq 189-192,fq 199-203,fq 205-207

**Literaturë e rekomanduar**

**a. Shqip**

1. Craford, A., Saul W., Mathews, R. S., & Makinster, J. (2005). *Strategji të mësimdhënies dhe të nxënit për klasat mendimtare.* Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik
2. Musai, B. përg. (2009). *Si të shkruajmë objektivat mësimorë për mësimdhënien dhe vlerësimin.* Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik
3. Musai, B. et.al (2008). *Mësimdhënia dhe të nxënit ndërveprues-modele mësimore në lëndë të ndryshme.* Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik

**b. Anglisht**

1. Borich, G.D.,(2000). *Effective Teaching Methods* (4th ed.).USA: Pearson.
2. Grigg, R. (2010). *Becoming an Outstanding Primary School Teacher*. England: Pearson.
3. Gronlund, N. E., & Brookhart, S. M. (2009). *Gronlund's writing instructional objectives* (8th ed.). Columbus, OH: Pearson.
4. Gronlund, N. E., & Waugh, C. K. (2009). *Assessment of student achievement* (9th ed.). Columbus,

| |
|---|
| OH: Pearson. |
| **Vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës, nëse ka.** |
| |

**Pedagogu i Lëndës**

**Dr. Majlinda HALA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTEVE TE BUKURA

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 247 597, www.uart.edu.al

**DEPARTAMENTI AKTRIM & TEORI**

**PROGRAMI STUDIMIT "FORMIMIT VAZHDUAR NE FUSHEN PSIKO-PEDAGOGJIKE PER USHTRIMIN E PROFESIONIT RREGULLUAR TE MESUESIT"**

# PROGRAMI I LËNDËS
# "PRAKTIKA MËSIMORE PEDAGOGJIKE
# MËSUESI

**Viti akademik 2023-2024**

**Titullari i Lëndës**
**Dr. MAJLINDA HALA**

**Përgjegjësi i Njësisë Bazë**
**Prof.Gazmend Gjoka**

**Dekani**
**Prof. Petrit Malaj**

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 247 597, www.uart.edu.al

## PARAQITJA E LËNDËS NGA PEDAGOGU

| | |
|---|---|
| NUMRI I KREDITEVE | 3 ECTS |
| NUMRI I ORËVE MËSIMORE NË KLASË | 75 ORË |
| FORMA E MËSIMDHËNIES | VËZHGIM I DREJPËRDREJTË |
| VITI AKADEMIK | 2023-2024 |
| SEMESTRI KUR ZHVILLOHET | I PARE |
| LLOJI I LËNDËS | E DETYRUESHME |
| PROGRAMI I STUDIMIT | "Formimi Vazhduar në Fushën Psiko – Pedagogjike për Profesionin e Rregulluar të Mësuesit" |
| ADRESA ELEKTRONIKE E TITULLARIT/E PEDAGOGUT TË LËNDËS | majlindahala@gmail.com |
| KODI I ETIKËS | Në tërësi VSA Nr. 23. Datë 06.03.2020, Mbi miratim e Kodit të Etikës në UART |

## PËRMBLEDHJA E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT

**Përshkrimi i lëndës:**

Praktika mësimore është një lëndë e rëndësishme në Programin "Master në Artet e Bukura ". Kjo lëndë synon:

- Të mundësojë përvojën praktike të punës si mësimdhënës në një nga institucionet arsimore,
- Të krijojë mundësi për të demonstruar aftësitë e tyre si mësimdhënës në profilin e artit figurativ në cikle të ndryshme , duke i përgatitur ata për tregun e punës.
- të aftësojë në përdorimin e kompetencave artistike në klasë të studentëve në veprimtari të ndryshme të mësimdhënies, duke provuar veten përballë nxënësve.
- Të aftësojë studentët në kuptimin dhe zbatimin e dokumenteve arsimore, duke i përdour ato.

Praktika duhet të përbëjë një përfitim për studentin dhe institucionin pritës, duke kombinuar aftësitë e studentit me interesat e institucionit. Në të gjitha rastet, studenti duhet të përcaktojë disa objektiva për praktikën të cilat paraqiten në dokumentin e marrëveshjes së praktikës dhe që përmbushja e tyre

vlerësohet gjatë dhe në fund të praktikës. Studenti duhet të marrë mbështetjen e duhur nga pedagogu udhëheqës i praktikës dhe mentori i institucionit.

**Rezultatet e të nxënit**

Gjatë zhvillimit të praktikës mësimore, studenti:

- zbaton njohuritë artistike të marra në shkollë duke zhvilluar aftësitë e mësimdhënies në klasë në mënyrë efektive;
- zhvillon aftësitë profesionale dhe pedagogjike përmes praktikës mësimore;
- promovon aftësitë e veta, duke marrë përsipër përgjegjësi dhe sfida si mësues në lëndën e artit pamor, të cilën përfaqësojnë.

**Metodologjia e mësimdhënies**

Veprimtari passive: ku studenti vëzhgon dhe kupton procesin mësimor nga hyrja në shkollë e deri në mbarim të mësimit.

Veprimtari aktive:

- ku studenti demonstron aftësitë e veta gjatë procesit të mësimdhënies.
- ku student ndërvepron me nxënësit duke zhvilluar teknika dhe metodologji të ndryshme mësimdhënie.

**Ngarkesa e punës gjatë praktikës profesionale**

Praktika e nivelit master kërkon në ditë *pune në javë (15 javë )* në një institucion arsimor të miratuar nga universiteti. Ngarkesa e punës gjatë praktikës përllogaritet në kredite si në çdo kurs tjetër të programit.

Kreditet e praktikës nga udhëheqësi, kur *mbikëqyrja është kryer nga mentori me nivelin e kërkuar profesional.* Studentët duhet të përgatiten për mbikëqyrje të drejtpërdrejtë pasi ka kaluar fazën e vëzhgimit nga mentori. Mbikëqyrja ndaj studentit për të vlerësuar nivelin profesional të tij, është detyra kryesore e *udhëheqësit të praktikës* dhe *mentorit në terren.*

Departamenti miraton kërkesat e detajuara për këtë detyrë si dhe ngarkesën e punës së studentit.

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 247 597, www.uart.edu.al

**Ditari i studentit dhe raporti final**

Studentit i kërkohet mbajtja shënim i gjithë punës dhe i përvojës siç është përcaktuar nga udhëheqësi i praktikës. Ditari është një mjet për *reflektim personal mbi praktikën profesionale* dhe për *integrimin e teorisë dhe kërkimit me përvojat e përditshme në klasë gjatë procesit mësimor.*

Ditari nuk është thjesht një kronikë e asaj që ndodhi në një ditë të veçantë, por ka si qëllim të ndihmojë studentin të interpretojë ngjarjet e ditës dhe rolin e tij në këto përvoja, gjatë procesit mësimor. Në disa raste, në varësi të llojit të vendit të praktikës dhe të rolit të studentit, mund të përcaktohet si më e efektshme që studenti të shkruaje *detyra të shkurtra për çështje* të përqendruara në aspekte specifike të përvojës, nëse vendoset kështu ndërmjet udhëheqësit dhe studentit.

**Një *raport final*** rreth dhjetë faqe *kërkohet në përfundim të praktikës profesionale*. Përcaktimi i kërkesave të raportit është përgjegjësi e udhëheqësit të praktikës. Çështjet dhe strukturat e pranueshme për këtë detyrë duhet të përcaktohen para se të fillojë periudha e praktikës dhe afatet për dorëzimin e detyrës tek udhëheqësi i praktikës duhet të përcaktohen që më parë.

Ditari i përvojës dhe raporti final *vlerësohen* sipas rregulloreve të përcaktuara nga departamenti.

**Kriteret etike**

- Studenti është i detyruar të zbatojë Kodin e Etikës së Universitetit të Arteve.
- Studenti duhet të respektojë mendimet dhe qëndrimet e të tjerëve.
- Studenti duhet të zbatojë rrëgullat për ndershmërinë akademike.

Studenti ***penalizohet*** nëse konstatohet *falsifikim të dhënash* mbi praktikën e kryer dhe në detyrat e lëndës, paraqitje e së njëjtës detyrë në të njëjtën lëndë ose në lëndë të ndryshme. Në këtë rast detyra ***nuk pranohet.***

**Vlerësimi**

Udhëheqësi dhe mentori në terren vlerësojnë studentin së bashku. Sigurisht, në terma akademikë, është udhëheqësi ai që është përgjegjës për vlerësimin final të një studenti. Gjithashtu rekomandohet që edhe studentët të kenë mundësi të vlerësojnë praktikën e tyre profesionale. Në kushte optimale, vlerësimi duhet të bëhet përmes dy vlerësimeve:

*Vlerësimi* vlerësim përmes vëzhgimeve të kryera dhe vlerësimit të mentorit në terren mes semestri

dhe në fund. *Vlerësimi final përqendrohet* në arritjet e përgjithshme të studentit dhe detyrën e dorëzuar.

***A. Vlerësimi në fund të praktikës mësimore*** ndjek këto kritere kryesore, duke bërë vlerësimin në një shkallë nga 1-5.

❖ Aftësia e praktikantit për të
- formuluar qëllimet e përshtatshme për kohëzgjatjen dhe llojin e praktikës së tij/saj;
- pranuar dhe plotësuar pjesën e tij/saj të përgjegjësisë;
- ndërvepruar në mënyrë të përshtatshme me personat e tjerë në punë dhe me klientët (fëmijët, etj.).

❖ Aftësia me të cilën praktikanti:
  - tregon iniciativë dhe pavarësi;
  - tregon motivim për të kryer aktivitete të praktikës mësimore;
  - mban marrëdhënie pozitive pune dhe ndërvepron me të tjerët me produktivitet;
  - pranon kritikën konstruktive dhe vepron për të vënë në zbatim rekomandimet.

❖ Aftësia me të cilën praktikanti:
  - për të ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi dhe të përshtatshme me fëmijët;
  - për të menaxhuar, kontrolluar dhe përfshirë sjelljen e fëmijës.

❖ Aftësia me të cilën praktikanti demonstron:
- progres në plotësimin e qëllimeve që vendosi për praktikën profesionale;
- përgegjësi në plotësimin e detyrave të ngarkuara;
- aftësi për të ndërtuar dhe mbajtur një marrëdhënie pune me kolegët, mentorin në terren dhe udhëheqësin;
- përgjegjësi për të përmirësuar njohuritë dhe / ose aftësitë e tij;
- aftësi për të planifikuar dhe për të punuar me nxënësit në cikle të ndryshme studimi.

***B. Vlerësimi i studentit për vendin e praktikës*** mund të përfshijë kritere të tilla, si:

- Gatishmëria e udhëheqësit dhe mentorit të terrenit për konsultime (psh. pamjaftueshëm/ përshtatshëm/ shumë e lartë);
- Ndërveprimet me personat e tjerë në punë (p.sh. iu dha pak pavarësi/shumë pavarësi; i përjashtuar nga pjesëmarrja e plotë/i pranuar si anëtar i ekipit; i trajtuar thjesht si "student"/ i

trajtuar si profesionist i ri; etj.);
- Kushtet e përgjithshme (psh. distanca, koha, çështje të mundshme të sigurisë, etj.);
- Vlerësimi i përgjithshëm: A do ta rekomandoje këtë vend për studentët e tjerë praktikantë?

## RREGULLA DHE PROCEDURA PËR ZHVILLIMIN E PRAKTIKËS

**Përcaktimi i institucionit të praktikës profesionale**

***Institucionet e kryerjes së praktikës,*** sipas rregullave të përgjithshme të caktuara nga rregullorja e Universitetit dhe vetë fakultetit, që vendosin standardet bazë për vendin e praktikës mësimore dhe mentorët në terren). Fakulteti kontakton dhe kontrakton përmes një marrëveshje bashkëpunimi, me MAS dhe ZVA për përcaktimin e shkollave në rrethin e Tiranës ku do të zhvillohen praktikat mësimore.

a) Lista emërore e studentëve *viti parë dhe dytë Master,* dorëzohet në fillim të vitit shkollor në ZVA, institucion i cili përcakton shkollat pritëse për zhvillimin e praktikës mësimore.
b) Të gjithë studentët e zhvillojnë praktikën mësimore në Tiranë, për ti dëhnë mundësi mentorimit nga ana e udhëheqësit të praktikës.
c) Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm që do të dorëzohet në ZVA për secilin student praktikant, që renditen si më poshtë:
   - Marrëveshja e bashkëpunimit me të gjitha ***institucionet publike arsimore*** e përgatitur dhe firmosur nga palët (dekani dhe Drejtori i ZVA). ***Nuk lejohet*** zhvillimi i praktikës mësimore në ***institucionet JO - publike arsimore.***
   - Lista e studentëve sipas shkollave të përcaktuara nga ZVA.
   - Dokumenti i pagesës, kryer nga UART së sigurimeve shëndetësore për çdo student.
d) Përcjellja e dokumenteve në ZVA nga udhëheqësi i praktikës mësimore, i cili ka përgjegjësinë kryesore.
e) Tërheqja de dokumentit individual për çdo student nga ZVA, dhe shpërndarja nga udhëheqësi i praktikës mësimore, i cili ka përgjegjësinë kryesore.

***Kryerja e praktikës mësimore,*** quhet e zhvilluar, nëse studenti zbaton me përpikmëri të gjitha kërkesat që ka kjo lëndë ashtu si të gjitha syllabuset e tjera. Sipas rregullave të përgjithshme të

caktuara nga rregullorja e Universitetit dhe fakultetit të Arteve të Bukura, duke përcaktuar kriteret mebi të cilën do të zhvillohet praktika mësimore , por edhe bazuar në të gjitha pikat e marrëveshjes së bashkëpunimit, studentit i quhet praktika e kryer nëse:

a) Është prezent në çdo orë të praktikës mësimore në shkollën ku ai është caktuar.
b) Demonstron etikë gjatë procesit mësimor, përgjatë kryerjes së praktikës me kolegët, nxënësit dhe drejtuesit e institucionit.
c) Demonstron aftësitë e duhura gjatë procesit mësimor në klasë.
d) Tregon përgjegjësi dhe korrektësi në zhvillimin e praktikës mësimore.
e) Raporton në periodikisht për praktikën e zhvilluar.
f) Realizon sasinë e orëve të parashikuara për praktikën.

Kontakti me udhëheqësin e praktikës mund të mbahet me ***telefon, me e-mail ose me teams brenda orareve që lejon etika.***

## KONCEPTET THEMELORE DHE TERMAT BAZË MBI TË CILAT NDËRTOHET LËNDA

***Konceptet themelore*** të cilat jepen nëpërmjet lëndës janë:

- Praktika mësimore
- Mësuesi
- Kurrikula
- Programi mësimor
- Planifikimi dhe llojet e tij
- Plan ditar
- Proces mësimor
- Vlerësimi dhe llojet e tij
- Metoda/teknika mësimdhënie
- Vlerësimi për të nxënë dhe i të nxënit
- Etj.

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 247 597, www.uart.edu.al

## TEMAT E LËNDËS

| PERIUDHA | TEMA |
|---|---|
| | **SEMESTRI I DYTË** |
| **Java e I** | **Përmbajtja e programit të praktikës mësimore, njohja me të.**<br>Kjo temë zhvillohet me të gjithë studentët, duke i njohur ata me kërkesat e zhvillimit të praktikës mësimore si: rregullat, frekuentimin e praktikës, kodin e etikës në institucionet shkollore, plotësimin e dokumenteve që janë të detyrueshme për tu dorëzuar në fund të praktikës etj. |
| **Java e II** | **Njohja me marrëdhënien teorikë - praktikë.**<br>Kjo temë ka si qëllim të njohë studentët me mënyrën e zbatimit të praktikës, duke i njohur me dy momentet kryesore të praktikës mësimore; pasive dhe aktive. Këto dy momentet duhet të respektohen si nga studenti ashtu edhe nga mentori që ndjek studentin gjatë praktikës. |
| **Java e III** | **Njohja me dokumentacionin individual të mësuesit AMU ose AML.**<br>Kjo temë ka si qëllim njohjen me dokumentacionin që mësuesi i lëndës përdor gjatë procesit mësimor si: *planifikimi vjetor, planifikimi i periudhës dhe planifikimi ditor*. Njohja zhvillohet gjatë praktikës passive, ku studenti gjatë vëzhgimit të orës mësimore, pyet për të gjitha elementet strukturore dhe lidhjen e tyre me programin mësimor apo dokumente të tjera. |
| **Java e IV** | **Zbatimi i dokumentacioneve: plani vjetor, planifikimi i periudhës, plan ditar.**<br>Kjo temë ka si qëllim *zbatimin e këtij dokumentacioni planifikimi vjetor, planifikimi i periudhës dhe planifikimi ditor* gjatë periudhës së praktikës active, që student do ti duhet të zbatojë dhe gjatë procesit mësimor. Zbatimi i këtyre dokumentve, të zhvillohet gjatë praktikës aktive. |
| **Java e V** | **Njohja me dokumentacione të tjera të mësuesit të artit pamor në shkollë.**<br>Kjo temë ka si qëllim që studenti të njihet me dokumente të tjera dhe mënyrën e plotësimit dhe mbajtjes së shënimeve. Dy dokumentacione të tjera të rëndësishme janë *regjistri dhe evidenca.* Studenti i njeh dhe pyet lidhur me elemente të ndryshme të këtyre dokumenteve që duhen plotësuar cdo ditë nga mësuesi. |
| **Java e VI** | **Bashkëbisedim mentor-student** ***për përgatitjen , organizimin e drejtimin e orës së mësimit.*** |

| | |
|---|---|
| | Kjo temë ka si qëllim që studenti të bashkëbisedojë me mentorin gjatë praktikës passive për të kuptuar mënyrën e përgatitjes së dokumentacioneve, organizimin dhe drejtimin e orës mësimore. Të tre këto komponentë janë mjaft të rëndëishëm të diskutohen me mentorin. |
| **Java e VII** | **Bashkëbisedime mentor-student për metodat dhe teknikat e të mësuarit.** Kjo temë ka si qëllim që studenti të bashkëbisedojë me mentorin gjatë praktikës passive lidhur me metodat dhe teknikat e mësimdhënies që student I shikon të zbatohen nga mentori gjatë orës mësimore, metoda të hartuara dhe parashikuara në plan ditar sipas temës mesimore. |
| **Java e VIII** | **Planifikimi i veprimtarive mësimore.** Kjo temë ka si qëllim që studenti gjatë planifikimit të plan ditarit në periudhën e praktikës active të planifikojë orën mësimore duke mirëmenduar situatën e të nxënit, mjetet dhe materialet, teknikat mësimore, strukturën e përdorur. |
| **Java e IX** | **Vlerësimi.** Kjo temë ka si qëllim që studenti gjatë planifikimit të plan ditarit në periudhën e praktikës active të planifikojë orën mësimore duke mirëmenduar mënyrën se si do kryejë vlerësimin e arritjeve të nxënësve. |
| **Java e X** | **Planifikimi i temave mësimore të trajtuara nga praktikanti me miratimin e mentorit.** Kjo temë ka si qëllim që studenti të dokumentojë temën mësimore që do të kryejë. |
| **Java e XI** | **Planifikimi i temave mësimore të trajtuara nga praktikanti me miratimin e mentorit.** Kjo temë ka si qëllim që studenti të dokumentojë temën mësimore që do të kryejë. |
| **Java e XII** | **Planifikimi i temave mësimore të trajtuara nga praktikanti me miratimin e mentorit.** Kjo temë ka si qëllim që studenti të dokumentojë temën mësimore që do të kryejë. |
| **Java e XIII** | **Planifikimi i temave mësimore të trajtuara nga praktikanti me miratimin e mentorit.** Kjo temë ka si qëllim që studenti të dokumentojë temën mësimore që do të kryejë. |
| **Java e XIV** | **Planifikimi i temave mësimore të trajtuara nga praktikanti me miratimin e mentorit.** |

| | |
|---|---|
| | Kjo temë ka si qëllim që studenti të dokumentojë temën mësimore që do të kryejë. |
| **Java e XV** | **Vlerësimi i rezultateve të arritura nga studenti.**<br>Kjo temë ka si qëllim që mentori së bashku me studentin ballafaqojnë arritjet gjatë praktikës mësimore, sipas treguesve të përcaktuara në dokumentin e (skedave) të cilat pas një miratimi nga të dy mentor-student, plotësohet nga ana e mentorit dhe vuloset nga drejtori i shkollës. |
| **Detyrimet e studentit** | Studenti duhet të dorëzojë pas përfundimit të praktikës:<br>1. Skedat e plotësuara nga mentori dhe vulosur nga drejtori i shkollës.<br>2. Deri në pesë (5) planifikime ditore që vetë studenti ka zhvilluar mësim.<br>3. Deri në tre (3) ditë shënime të mbajtura në orë të ndryshme gjatë praktikës passive. Shënimet duhet të mbahen në lidhje me: a) RN e parashikuara nga mentori; b) teknikat e përdorura c) vlerësimin e nxënësit.<br>4. Deri në dy (2) ditë shënime të kryera për një nga shokët /shoqet që student ka ndjekur gjatë zbatimit të praktikës mësimore. Shënimet duhet të mbahen në lidhje me: a) RN e parashikuara nga mentori; b) teknikat e përdorura c) vlerësimin e nxënësit, duke nxjerrë në pah aftësitë e përdorura nga shoku/shoqja. |

## FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

## FREKUENTIMI

1. Studenti duhet të frekuentojë jo më pak se 75% të praktikës.
2. Nëse frekuentimi i studentit është më pak se 75% e praktikës në një vit akademik, atëherë ai detyrohet të kalojë në frekuentimin e saj në vitin pasardhës sipas rregullores së ciklit të dytë të studimeve të UART.

## KONTROLLI I VAZHDUESHËM DO TË NXIRRET NGA KËTO ELEMENTE:

a) Pjesëmarrje aktive në orën e mësimit: **10%**
b) Puna e pavarur krijuese: **20%**
c) Detyrat e kursit: **20%**
d) Projektet e kursit: **20%**
e) Provimi përfundimtar: **30%**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTEVE TE BUKURA

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 247 597, www.uart.edu.al

## SISTEMI I VLERËSIMIT TË STUDENTIT

| Nota | Në % | Përkufizimi |
|---|---|---|
| 10 | 91-100% | SHKËLQYESHËM |
| 9 | 81-90% | SHUMË MIRË |
| 8 | 71-80% | MIRË |
| 7 | 61-70% | KËNAQSHËM |
| 6 | 51-60% | MJAFTUESHËM |
| 5 | 40-50% | DOBËT |
| 4 | 00-39% | KEQ |

## LITERATURA

### Literaturë bazë e detyrueshme

**a)Literatura bazë, e detyrueshme:**

IZHA, 2014-2018, Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, arti pamor, klasat 1- 5 dhe 6-9.

IZHA, 2014-2018, Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, arti pamor, klasat 10- 12.

IZHA, 2016, Kurrikula artistike, pë shkollat me drejtim të orientuar artistik, klasat 1-12.

IZHA, 2015-2018, Programet e artit pamor, klasat 10-12.

IZHA, 2018, Udhëzuesi i kurrikulës lëndore të artit pamor në arsimin e mesëm të ulët

IZHA, 2018, Udhëzuesi i kurrikulës lëndore të artit pamor në arsimin e mesëm të lartë.

### Literaturë e rekomanduar

**b) Literatura e rekomanduar:**

IZHA, 2014, Korniza kurrikulare.

IZHA, 2014, Kurrikula arteve AMU, klasat 1-9.

IZHA, 2015, Kurrikula arteve AML, klasat 10-12.

**Vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës, nëse ka.**

**Pedagogu i Lëndës**

**Dr. Majlinda HALA**